



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare
www.legjislacioni.gov.al

Nr. 63

Datë 7 maj 2014

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 36/2014 datë 10.4.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 032, datë 11.12.2008, “Për policinë e burgjeve”.....	2411
Ligj nr. 37/2014 datë 10.4.2014	Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar	2416
Vendim i Kuvendit nr. 23/2014 datë 17.4.2014	Për disa shtesa në vendimin e kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar	2416
Dekret nr. 8547 datë 23.4.2014	Për emërim gjyqtari	2417

LIGJ
Nr. 36/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË
LIGJIN NR. 10 032, DATË 11.12.2008, “PËR
POLICINË E BURGJEVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i normave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Burgjeve, për pranimin, ecurinë e karrierës dhe mbarimin e marrëdhënieve të punës, për garantimin e të drejtave, detyrave dhe përgjegjësisve të punonjësve të këtij shërbimi.

2. Policia e Burgjeve ushtron juridiksionin e vet në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Përkufizime

1. “Punonjës i Policisë së Burgjeve”, në kuptim të këtij ligji, janë ata punonjës të Policisë së Burgjeve në nivel qendror dhe IEVP-je, të cilët ushtrojnë detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese për garantimin e rendit e të sigurisë në IEVP.

2. “IEVP” janë institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale për të dënuarit dhe të paraburgosurit, përfshirë edhe ato ku trajtohen kategori të veçanta të tyre, për shkak të moshës, gjendjes shëndetësore dhe përcaktimeve të tjera të bëra në aktet ligjore e nënligjore.

3. “Regjim i brendshëm” janë mjediset e fjetjes së të dënuarve dhe të të paraburgosurve, mjediset e punës, mjediset e veprimtarive profesionale e kulturore dhe ato të përbashkëta.

4. “Lirim nga Policia e Burgjeve” është ndërprerja e marrëdhënieve juridike dhe administrative të punonjësit të

Policisë së Burgjeve me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për arsye të cilat nuk ia heqin të drejtën për t’u rikthyer në Policinë e Burgjeve.

5. “Largim nga Policia e Burgjeve” është ndërprerja e marrëdhënieve juridike dhe administrative të punonjësit të policisë me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve pa të drejtë rikthimi në Policinë e Burgjeve.

6. “Masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në IEVP” është tërësia e veprimeve të ligjshme, të cilat duhet të kryhen nga punonjësi i Policisë së Burgjeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, si dhe me zbatimin e skemave të sigurisë.”.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Misioni dhe statusi i Policisë së Burgjeve

1. Misioni i Policisë së Burgjeve është garantimi i rendit dhe sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

2. Policia e Burgjeve është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve gëzojnë të drejtat që burojnë nga ky ligj dhe statusi i tyre nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo fatkeqësie natyrore.

4. Policia e Burgjeve është strukturë e depolitizuar, punonjësit e saj janë pjesë e administratës publike dhe gëzojnë të gjitha të drejtat për trajtim ekonomik-financiar, si Policia e Shtetit.”.

Neni 4

Në nenin 4, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përdor uniformën, shenjat dhe simbolet e Policisë së Burgjeve, vetëm gjatë kryerjes së detyrës.”.

Neni 5

a) Në nenin 5, pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:

“1. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht në ligj dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme, nuk mbajnë armë vdekjeprurëse brenda regjimit të brendshëm të burgut.

2. Mbajtja e mjeteve të tjera në regjimin e brendshëm të burgut, si shkopinj gome, pranga, zinxhirë, lejohet vetëm kur nevojiten për garantimin e elementeve të sigurisë.”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Punonjësi i Policisë së Burgjeve përdor armët e zjarrit që ka në përdorim, vetëm në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.”.

Neni 6

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Pjesëmarrja në sindikata

1. Sindikata e Policisë së Burgjeve ka për qëllim përfaqësimin e punonjësve anëtarë të Policisë së Burgjeve, në të gjitha çështjet që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës së tyre dhe efikasitetin në punë.

2. Sindikata e Policisë së Burgjeve përfaqëson punonjësit anëtarë të sindikatës, në të gjitha rastet e apelimit për çdo çështje të ngritur, në mbështetje të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

3. Të gjithë punonjësit e Policisë së Burgjeve, me përjashtim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, mund të jenë anëtarë të sindikatës.”.

Neni 7

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Organizimi i Policisë së Burgjeve

1. Policia e Burgjeve organizohet në nivel qendror dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP).

2. Policia e Burgjeve drejtohet nga Drejtoria e Policisë së Burgjeve dhe organizohet sipas shërbimeve përkatëse, të miratuara me akte nënligjore.

3. Në nivel qendror, Drejtoria e Policisë së Burgjeve është pjesë e strukturës dhe e organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

4. Struktura e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve, në nivel IEVP-je, është pjesë e strukturës dhe organikës së çdo IEVP-je.”.

Neni 8

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Përgjegjësitë e Policisë së Burgjeve

Policia e Burgjeve, në ushtrimin e veprimtarisë së saj, ka këto përgjegjësi:

1. Garantoni sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

2. Merr masa për zhvillimin e veprimtarive të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucion.

3. Merr masa për shoqërimin, sigurinë fizike të të paraburgosurve dhe të dënuarve, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale penale.

4. Zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit apo transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve nga një institucion në një tjetër.

5. Zbaton rregullat e sigurisë gjatë shoqërimit për zhvillimin e seancave gjyqësore.

6. Siguron ruajtjen e personave të paraburgosur dhe të dënuar në spitale publike dhe private.

7. Merr masa për sigurimin e jetës dhe të shëndetit të personave të paraburgosur dhe të dënuar, si dhe të institucionit, në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore.

8. Kontrollon për sende të ndaluara të paraburgosurit dhe të dënuarit, regjimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe personat që hyjnë dhe dalin në regjimin e brendshëm.

9. Policia e Burgjeve, në përputhje me urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Ministri i Drejtësisë, kryen edhe detyra të tjera që lidhen me ruajtjen fizike të objekteve dhe institucioneve, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.”.

Neni 9

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Drejtori i Policisë së Burgjeve

1. Drejtoria e Policisë së Burgjeve është autoriteti më i lartë administrativ tekniko-profesional i Policisë së Burgjeve.

2. Drejtoria e Policisë së Burgjeve:

a) drejton dhe kontrollon policinë;

b) i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve marrjen e masave për garantimin e rendit e të sigurisë në institucione;

c) përgjigjet për gjendjen e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.”.

Neni 10

Në nenin 13, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës, trajnimit, ecures në karrierë dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës përcaktohen në rregulloren e personelit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 11

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kur, për arsye pune e shërbimi, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se muaji mars i vitit pasardhës, në të kundërt bëhet kompensimi në vlerë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky trajtim bëhet edhe për orët shtesë të punës dhe të shërbimit.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme apo të fatkeqësive natyrore, koha e punës deri në 24 orë mbi kohën normale të shërbimit, brenda 3 muajve, nuk trajtohet si orë shtesë pune.”.

Neni 12

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 15
Rregullimi i pagave**

1. Paga e punonjësit të Policisë së Burgjeve caktohet sipas gradës dhe funksionit.

2. Paga mujore e punonjësit të Policisë së Burgjeve përbëhet nga paga bazë, që është paga për gradë, dhe nga shtesa të tjera, referuar kushteve të punës dhe funksionit përkatës.

3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve përfitojnë çdo vit, në fund të vitit financiar, sipas vlerësimit të punës, një shpërblim, sipas përcaktimit të bërë në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky shpërblim, sipas ratit, mund të jetë i njëjtë ose të jepet në bazë të një shkalle përpjesëtueshmërie, që pasqyron kohën e punës së kryer nga punonjësi gjatë vitit financiar.

4. Skema e pagave të punonjësve të Policisë së Burgjeve miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Punonjësve të Policisë së Burgjeve, të cilët janë të punësuar në IEVP-të që ndodhen larg qendrave të banimit, u garantohet transporti falas vajtje – ardhje nga vendi i punës (IEVP) vetëm për efekt shërbimi. Rregullat e hollësishme për mënyrën e organizimit e të funksionimit të transportit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.”.

Neni 13

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Përparësia për rikthim dhe pranim në strukturat e Policisë së Burgjeve.”.

2. Paragrafi ekzistues numërohet pika 1.

3. Pas pikës 1 shtohen pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje:

“2. Kanë përparësi për pranim në Policinë e Burgjeve shtetasit që kanë përvojë pune në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Forcat e Armatosura dhe Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë.

3. Mënyra e vlerësimit dhe ekuivalentimit të gradave të këtyre punonjësve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 14

Në nenin 17, pika 1, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) ka mbaruar arsimin e mesëm;”.

Neni 15

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 17/1
Trajnimi**

Kandidati, i cili përzgjidhet për t’u pranuar si punonjës i Policisë së Burgjeve, duhet të kryejë trajnimin bazë të Policisë së Burgjeve në përputhje me rregulloren e personelit. Pas përfundimit të trajnimit i nënshtrohet një periudhe prove njëvjeçare. Në përfundim të periudhës së provës konfirmohet ose jo si punonjës i Policisë së Burgjeve.”.

Neni 16

Në nenin 18, fjala “ministri” zëvendësohet me fjalët “Ministri i Drejtësisë”.

Neni 17

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 19
Kriteret për emërimin e Drejtorit të Policisë së Burgjeve**

Drejtor i Policisë së Burgjeve mund të emërohet personi që plotëson kriteret e mëposhtme:

- a) është shtetas shqiptar;
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- c) është në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht, për të kryer detyrën;
- ç) ka arsimin e lartë;
- d) nuk është dënuar penalisht me vendim gjykate të formës së prerë;
- dh) ka shërbyer në Policinë e Burgjeve ose në Policinë e Shtetit për një periudhë, të paktën, 10-vjeçare, ku në tri nga këto vite të ketë mbajtur gradë të rolit të lartë.”.

Neni 18

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 19/1
Largimi i Drejtorit të Policisë së Burgjeve**

Drejtori i Policisë së Burgjeve mund të largohet nga detyra për këto arsye:

- a) është dënuar për një vepër penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- b) ka kryer shkelje, duke cenuar rendin dhe sigurinë në burg;
- c) është i paaftë nga ana shëndetësore, për një periudhë deri në 6 muaj;
- ç) plotëson moshën e pensionit;
- d) jep dorëheqjen nga detyra.”.

Neni 19

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Emërimi, lirimi ose largimi i punonjësve të Drejtorisë së Policisë së Burgjeve

1. Punonjësit e rolit bazë dhe të mesëm emërohen, lirohen ose largohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve mbi bazën e propozimit me shkrim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve.

2. Punonjësit e rolit të lartë drejtues emërohen, lirohen ose largohen nga Ministri i Drejtësisë, bazuar në propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.”.

Neni 20

Në nenin 21 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “propozimin e” shtohen fjalët “me shkrim të”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Punonjësit e Policisë së Burgjeve, të rolit bazë dhe të mesëm, që nuk japin pëlqimin për transferim, paraqiten në detyrë, por mund të ankohen respektivisht te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe Ministri i Drejtësisë, të cilët shqyrtojnë ankesën dhe shprehen përfundimisht brenda 30 ditëve.”.

Neni 21

Në nenin 22, pika 1, para fjalëve “me urdhër” shtohen fjalët “me propozimin me shkrim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe”.

Neni 22

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Lirimi dhe largimi nga Policia e Burgjeve

1. Punonjësi i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra kur:

a) deklarohet i paaftë nga ana shëndetësore me vendim të komisionit mjeko-ligjor;

b) i shkurtohet funksioni organik dhe nuk kërkon uljen në gradë;

c) punësohet në struktura të tjera të administratës publike;

ç) mbush moshën për pension të plotë pleqërie;

d) nuk kalon kursin në Qendrën e Trajnimit;

dh) kërkon vetë të lirohet.

2. Punonjësi i Policisë së Burgjeve largohet nga detyra nëse dënohet me burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë, si dhe kur ndaj tij merret masa disiplinore e largimit nga Policia e Burgjeve.

3. Lirimi ose largimi i punonjësit të Policisë së Burgjeve bëhen me urdhër të titullarit kompetent për emërimin e tij.

4. Një person i liruuar, sipas pikës 1 të këtij neni, shkronjave “a”, “b”, “c”, “d” e “dh”, mund të ripranohet në Policinë e Burgjeve, kur ka vende vakante në pozicionin për të cilin ai ka kualifikimin e duhur. Nëse ripranimi bëhet brenda 12 muajve të pandërprerë, atëherë ai rifiton gradën e tij të mëparshme.

Nëse ripranimi bëhet pasi kanë kaluar 12 muaj të pandërprerë, punonjësi i Policisë së Burgjeve vazhdon karrierën një gradë më poshtë nga ajo që mbante ose ricertifikohet për gradën që mbante më parë.”.

Neni 23

Në nenin 25, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Emërtimet e roleve në Policinë e Burgjeve, sipas hierarkisë, janë:

a) punonjës i rolit bazë, që përfaqëson rolin bazë të veprimit policor;

b) punonjës i rolit të mesëm, që përfaqëson drejtimin në institucione;

c) punonjës i rolit të lartë drejtues, që përfaqëson drejtimin qendror;

ç) Drejtor i Policisë së Burgjeve.”.

Neni 24

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Emërtimet e gradave, sipas roleve dhe ecurisë në karrierë, janë:

a) për punonjësit e rolit bazë:

i) nëninspektor;

ii) inspektor;

iii) kryeinspektor;

b) për punonjësit e rolit të mesëm:

i) nënkomisar;

ii) komisar;

iii) kryekomisar;

c) për punonjësit e rolit të lartë:

i) drejtues;

ii) drejtues i parë;

ç) Drejtor i Policisë së Burgjeve.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Grada e Drejtorit të Policisë së Burgjeve merret me emërimin në detyrë si Drejtor i Policisë së Burgjeve dhe lihet me lirimin ose largimin nga detyra.”.

Neni 25

Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Hierarkia ndërmjet punonjësve të policisë në role përcaktohet brenda rolit nga grada më e lartë në gradën më të ulët dhe ndërmjet roleve nga roli më i lartë te roli më i ulët.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 26

Në nenin 29 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalët “në qendrën e trajnimit” zëvendësohen me fjalët “të trajnimit”.

2. Në pikën 3, fjalët “hyjnë në qendrën e trajnimit” zëvendësohen me fjalët “hyjnë në trajnim”.

3. Në pikat 4 dhe 5, pas fjalëve “ndiqet një kurs formimi” hiqen fjalët “në qendrën e trajnimit”.

4. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Punonjësit të policisë i lind e drejta të aplikojë për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes, në rast se ka vende të lira, pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:

- a) nga “Inspektor” në “Kryeinspektor”, 3 vjet;
- b) nga “Kryeinspektor” në “Nënkomisar”, 3 vjet;
- c) nga “Nënkomisar” në “Komisar”, 4 vjet;
- ç) nga “Komisar” në “Kryekomisar”, 4 vjet;
- d) nga “Kryekomisar” në “Drejtues”, 4 vjet;
- dh) nga “Drejtues” në “Drejtues I”, 5 vjet;
- e) nga “Drejtues I” në “Drejtor i Policisë së Burgjeve”, pa afat kohor.”.

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Në vjetërsinë, për efekt grade, llogaritet koha, gjatë të cilës ai ka kryer shërbim aktiv në strukturat e Policisë së Burgjeve ose në shërbimet e tjera policore.”.

6. Pas pikës 9 shtohen pikat 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“10. Punonjësi i Policisë së Burgjeve ka të drejtë të ankohet te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, në rastet kur konstaton shkelje të rregullave të ngritjes në gradë, të përcaktuara në këtë nen dhe në rregulloren e personelit.

11. Procedurat për kryerjen e provimit të ngritjes në gradë përcaktohen në rregulloren e personelit të Policisë së Burgjeve, ku përfshihen:

- a) përbërja e komisionit të testimit;
- b) procedurat e aplikimit;
- c) kriteret për të aplikuar.”.

Neni 27

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Ngritja në gradë për nivelin bazë dhe të mesëm bëhet nga Drejtori i Policisë së Burgjeve, me propozim të komisionit përkatës.

2. Në pikën 6 fjala “Komisar” zëvendësohet me fjalën “Kryekomisar”.

Neni 28

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “për rolin e mesëm dhe rolin e lartë” zëvendësohen me fjalët “rolin bazë, rolin e mesëm dhe rolin e lartë”.

2. Në pikën 2, fjalët “për rolin e mesëm” zëvendësohen me fjalët “për rolin bazë dhe rolin e mesëm”.

Neni 29

Në nenin 33, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Me krijimin e vendeve të lira për gradë, punonjësi i policisë, që ka kërkuar uljen në gradë, mund të rimarrë gradën e mëparshme, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 26.”.

Neni 30

Në nenin 36 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronjat “ç” dhe “d”, të pikës 1, ndryshohen si më poshtë:

“ç) ulje në gradë, jo më shumë se një gradë ose funksion deri në 12 muaj;

d) largim nga Policia e Burgjeve.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të jetë dhënë masa disiplinore nga organi kompetent.”.

3. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. Vendimi për masën disiplinore duhet t'i komunikohet me shkrim punonjësit të Policisë së Burgjeve brenda 5 ditëve pune nga marrja e tij, duke e vënë në dijeni njëkohësisht edhe për të drejtën e tij të ankimit për vendimin.

5. Kategoritë dhe llojet e shkeljeve disiplinore, kriteret, rregullat, procedurat dhe dokumentacioni për dhënien e masave disiplinore, si dhe përbërja, mënyra e organizimit dhe e funksionimit të komisionit të apelimit të punonjësve të Policisë së Burgjeve përcaktohen në rregulloren e disiplinës.”.

Neni 31

Në nenin 38, shkronjat “c”, “ç” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:

“c) Ministri, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për punonjësit e rolit të lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit të mesëm, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me propozimin me shkrim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit bazë, për masën disiplinore “Ulje në gradë”;

ç) Ministri i Drejtësisë, me propozimin me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, për drejtorin dhe përgjegjësit e sektorëve në Drejtorinë e Përgjithshme të

Burgjeve, për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”;

d) Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, në bazë të propozimit me shkrim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve, për punonjësit e rolit bazë, për masën disiplinore “Largim nga Policia e Burgjeve”.

Neni 32

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të neneve 10, 12 dhe 13 të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8552, datë 5.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 37/2014

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 8308, DATË 18.3.1998, “PËR TRANSPORTET RRUGORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 10, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.”.

Neni 2

Në nenin 14, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Tarifa e llojit të biletës në transportin qytetas të udhëtarëve me autobus miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me nivelin e standardit të kërkuar për këtë shërbim.”.

Neni 3

Në fund të nenit 85 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 10.4.2014

Shpallur me dekretin nr. 8553, datë 5.5.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM Nr. 23/2014

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 48/2013, “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 55, pika 1, e 21, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 48/2013, “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

I. Deputetët Gjergji Papa, Gerti Bogdani, Liliana Elmazi dhe Voltana Ademi caktohen anëtarë në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Deputeti Gledjon Rehovica caktohet anëtar në Komisionin për Ekonominë dhe Financat.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 17.4.2014

**KRYETARI
Ilir Meta**

DEKRET
Nr. 8547, datë 23.4.2014

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4, të Kushtetutës si dhe të nenit 12, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë“, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Gentiana Xhelili, emërohet gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 12 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006